



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:293934

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06634032

C.nr.795/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë të paditësve: A.H, A.V, A.S, A.P dhe A.H1 që të gjithë nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës, me datë 20.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësve: A.H, A.V, A.S, A.P dhe A.H1 që të gjithë nga Rahoveci, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, në çështjen juridike kontestimore C.nr.795/2024.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit A.H, A.V, A.S, A.P dhe A.H1 që të gjithë nga Rahoveci, pranë kësaj gjykate me datë 22.08.2024, përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. D.M nga Prizreni, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike - kompensimi nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

Kjo gjykatë me Aktvendimin C.nr.795/2024 të datës 28.10.2024, i ka ftuar paditësit që në afat prej 3 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit, ta përmirësojnë dhe plotësojnë padinë, ashtu që ta përcaktojnë saktë periudhën kohore për të cilën kërkojnë kompensim, si dhe shumën e kërkuar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e precizojnë – përmirësojnë, do të konsiderohet se e kanë tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletë kthesa se përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, me datën 07.11.2024, e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka precizuar – përmirësuar padinë sipas aktvendimit të gjykatës.

Sipas nenit 102.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit

*të caktuar e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësa do të hidhet poshtë”.*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësit nuk e kanë bërë precizimin dhe plotësimin e padisë brenda afatit të përcaktuar, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 102.3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.795/2024, me datë 20.12.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale

Adelina Çmega

Gjyqtari

Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.